



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr : 04-353/01-35024

Data: 23.10.2025

P r i z r e n

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIROR KK – PRIZREN, me kërkesën e Drejtorise për Shërbime Publike- Komuna e Prizrenit , me të cilën pala ka kërkuar leje për: **“Ndërtimin e infrastrukturës në lagjen “ Jeta e Re “- Prizren ,** e në bazë të e në bazë të nenit 3 paragrafit 1,pika 1.27 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor me Nr.04/L-174 të Dt.31.07.2013,nenit 3.1.1,1.2,1.4,1.17,1.24, e në lidhje me nenin 4,1.2,si dhe nenit 5,1.1 e lidhur me nenin 14.1.4,të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110,si dhe konform nenit 40 alinea 4 dhe nenit 41 alinea 1,dhe të nenit 45 e lidhur me nenin 51, dhe sipas konform Vendimit për miratimin e sipas vendimit për miratimin e HZK për periudhën 2022-2030 Nr.001-011-48192 të dt 31.03.2022dhe në harmoni me dispozitat 3.alenia 1 pika 1.1,1.3,1.5 dhe 1.5 , dhe të nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 82.83 e në lidhje me nenin 84.85. LPA-së nr. 02/L-28, merr këtë:

A K T V E N D I M

I LEJOHET - Drejtorise për Shërbime Publike- Komuna e Prizrenit , me të cilën ka kërkuar leje për: **“Ndërtimin e infrastrukturës në lagjen “ Jeta e Re” kjo leje vlen vetëm për ato rrugë që janë të përfshirë në Hartën Zonale .**

- I.** Dokumentacioni teknik e mban titullin e tipit të veçantë-Projekti I punuar nga Byroja projektuese “STUDIO HAPSIRA” SH.P.K.-Prishtinë.
- II.** Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin komunal në afat prej 8 dite.
- III.** Investitori është i obliguar që punimet të kryen në bazë të dokumentacioni teknik-projektë e në pajtim me normat ndërtimore dhe rregullave të përkohshme teknike për kësi llojë punime
- IV.** Investitori është i obliguar që punimet rreth infrastrukture të kryen sipas Aktvendimit të dhëna, kurse vend punimi natën të ndriqohet me dritë, kurse materialet të tjera duhet të menjanohen nga rruga ku janë kryer punimet.
- V.** Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12(dymbdhjetë) muajsh,duke llogaritur nga dita e marjes së të njejtës
- VI.** Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vendpunishten menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme.
- VII.** Pas përfundimit të ndërtimit investitori duhet të parashtojë kërkesën për pranimin teknik dhe marrjen e lejes për shfrytëzim.
- VIII.** Në qoftëse punimet në infrastrukture nuk mund të kryen në afatin e lejuar, Investitori është i obliguar që të kërkojë nga ky organ leje për vazhdimin e afatit të punimeve.
- IX.** Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12 (dymbdhjetë) muajsh,duke llogaritur nga dita e marjes së të njejtës.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim për plotësimin e dokumentacionin 04-353/01-35024 dt. 05.08.2025
- Pëlqimi nga "KEDS" Sh.A.
- Pëlqimi nga Kom. "Hidroregjioni Jugor",
- Pëlqimi nga Telekom I Kosovës –PTK-ja.

P.S. DSHP gjatë implementimit të projektit merr përsipër për problemet eventuale që mund të dalin lidhur me infrastruktur dhe çështje pronësore juridike duke bërë zgjidhje sa më të mire të mundshme.

A r s y e t i m

Drejtoria e Shërbimeve Publike - Komuna e Prizrenit , me të cilën pala ka kërkuar leje për: ndërtimin e infrastrukturës në lagjen "Jeta e Re " kjo leje vlen vetëm për ato rrugë që janë të përfshirë në Hartën Zonale në Prizren, është drejtuar këtij organi për marrjen e lejes për :

Ndërtimin e infrastrukturës në lagjen "Jeta e Re " në Prizren .

Duke shqyrtuar kërkesën e Investitorit si dhe dokumentacionit teknik dhe të shtojcave tjera të prezentuara s'bashku me kërkesë vërtetohet se:

Në procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.


Në kuptim të dispozitave të lartë theksuara është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për :

Ndërtimin e infrastrukturës në lagjen "Jeta e Re " në Prizren .

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.


KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marjes së të njëjtës MMPHI së-Prishtinë.

Bashkëpunëtor profesional:



Afërdita Mormorina, inxh.dip.ark.

DREJTORI:


Pranverim Berisha,jur.